



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 05
Prishtinë, më 08 mars 2012, në orën 10:00 salla C-203
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, z. Bedri Hamza -ministër-Ministria e Financave, z. Ramadan Sejdiu - Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, z. Driton Selmanaj- KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.02.2012,**
3. **Diskutim rreth nismës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, Ligjit nr. 03/L-075.**

Të ftuar: z.Bedri Hamza - ministër i Ministrisë së Financave,
z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm

4. **Të Ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Ramiz Lladrovci – Propozoi që pika tre e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit, sepse prezenca e ministrit është e domosdoshme në mbledhje.

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se me kërkesë të ministrit mbledhja e Komisionit e planifikuar për datën 07 mars 2012, është shtyrë për datën 8 mars 2012. Edhe pse ministri i MF gjithmonë i është përgjigjur ftesës së Komisionit, në këtë mbledhje nuk ka arritur t'i përgjigjet ftesës. Ftoi anëtarët e Komisionit që të deklarohen nëse janë për të vazhduar me këtë mbledhje ose jo. Hap diskutimin.

Menderes Ibra, MF (këshilltar i ministrit) - arsyeja e mospjesëmarrjes së ministrit në këtë mbledhje është se në të njëjtën kohë është duke marrë pjesë në mbledhjen e Qeverisë. zv.Ministri është i sëmur dhe është në trajtim jashtë vendit.

Armend Zemaj – Grupi punues që është marrë me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, Ligjit nr. 03/L-075, gjatë punës është takuar edhe me Ministrin dhe Departamentin e Thesarit. Në këtë fazë - se a duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji dhe a duhet ta marr përgjegjësinë për këtë Komisioni ose Qeveria, në këtë mbledhje duhet të jetë ministri i pranishëm, sepse kjo më tepër është çështje politike se sa çështje administrative. Kuvendi ka nxjerr vendimin me të cilin është përkrahur raporti me rekomandime të Komisionit. Qeveria nuk ka përmbushur këtë vendim, sepse nuk ka paraparë ndryshimin e këtij Ligji në programin legjislativ, dhe lidhur me këtë nuk duhet heshtur.

Valbona Dibra- Tha se ministri i MF është personi që gjithmonë i është përgjigjur ftesës së Komisionit. Por, Komisioni ka rregullat e veta dhe kjo pike duhet të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Grupi punues ka vlerësuar se ky Ligj duhet të ndryshohet dhe të plotësohet. Ky rekomandim i Grupit punues është përkrahur nga Komisioni dhe Kuvendi, prandaj prezenca e ministrit është e nevojshme për të sqaruar se pse ky Ligj nuk është përfshirë në programin legjislativ për këtë vit.

Bali Muharremaj - Ndau mendimin me anëtarët e Komisionit që shqyrtimi i pikës tre të rendit të ditës, të shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Kryetari – Tha se kjo pikë shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit. Se kur do të mbahet kjo mbledhje, varet nga agjenda e ministrit.

Armend Zemaj – Ishte kundër idesë që Komisioni t'i përshtatë agjendën e tij përfaqësuesve të institucioneve, sepse atëherë Komisioni nuk arrin ta respektoj agjentin e tij të përcaktuar me plan të punës dhe me rregulla të veta të brendshme.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Pika tre e rendit të ditës shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Komisionit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.02.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.02.2012, pa vërejtje.

4. Të ndryshme

a). Përzgjedhja e auditorit të jashtëm për auditimin e ZAP-it, për vitin 2011

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se në bazë të autorizimit që i është dhënë nga

Komisioni, brenda afatit ligjor ka formuar për herë të dytë Komisionin Vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e ZAP-it, për vitin 2011. Për përzgjedhjen e Kompanisë audituese, Komisioni vlerësues do ta njoftoj Komisionin dhe Kryesinë e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu